



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.10.2025

Numër Protokolli: 7007/2025

A.nr.1636/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, dnë përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1636/2025, të datës 28.08.2025, të parashtruar nga ankuesja, A.Z, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.10.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1636/2025, e datës 28.08.2025, e parashtruar nga ankuesja A.Z.

II. Anulohet konkursi me Nr. Reference: RN00017448 për grupin e përgjithshëm të mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Politika i shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe të gjitha veprimet që janë ndërmarr si rezultat i këtij procesi.

III. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr të gjitha veprimet si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, A.Z (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 28.08.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër konkursit me Nr. Reference: RN00017448 për grupin e përgjithshëm të mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Politika i shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 09.09.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje referuar MMPHI), ndërsa kjo e fundit, më datë 25.09.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5774/2025, të datës 28.08.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim për kandidatin fitues, i datës 30.07.2025; Konkursin me numër reference RN00017448, të datës 25.03.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 28.08.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.09.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 25.09.2025, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Njoftim për kandidatin fitues, të datës 30.07.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve, e datës 30.07.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatët në intervistë, të datës 20.06.2025; Pyetjet në intervistën me gojë, të datës 20.06.2025; Njoftim për intervistën me gojë, të datës 18.06.2025; Njoftim për kandidatët që e kanë kaluar testin me shkrim, i datës 11.06.2025; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatëve nga komisioni i pranimi; Pyetjet e hapura për testin individual; Njoftim me e-mail, i datës 23.09.2025; Testi individual i ankuese A.Z, i datës 02.06.2025; Njoftim i datës 30.05.2025; Vendim me numër protokolli Nr.02/4285-2/2, i datës 30.05.2025; Vendim për formimin e komisionit me numër protokolli Nr.02/4285/25, i datës 29.05.2025; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit, i datës 07.03.2018; Vendim me numër protokolli Nr.02/817/25, i datës 13.02.2025; Akt emërim me numër AE.Nr.06/2023, i datës 20.04.2023; Njoftim, i datës 27.05.2025; Lista e aplikantëve (aprovuar dhe refuzuar); Njoftim i datës 22.05.2025; Lista e kandidatëve në pritje; Vendim me numër protokolli Nr.02/3782/25, i datës 08.05.2025; Aplikacioni me datë aplikimi 27.03.2025, të kandidatit B.K, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 23.04.2025, të ankuses A.Z, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuses **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se MMPHI, më datë 25.03.2025, ka shpall konkursin me Nr. Reference: RN00017448, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Politika, si kategori e specialistit, i hapur për aplikim nga data 26.03.2025 deri më datën 24.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar gjithsej 37 kandidatë, ku prej tyre 9 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja janë përfshirë në fazën e verifikimit paraprak.

Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i MMPHI-së më datë 30.07.2025 ka shpallur listën përfundimtare të vlerësimit ku sipas saj rezulton se ankuesja ka marr gjithsej 56.4 pikë në testin me shkrim ndërsa në intervistën me gojë ndërsa në intervistën me gojë nuk ka marrë pjesë.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se janë bërë shkelje në këtë procedurë dhe parregullsi sikurse është thënë në Vendimin me nr. prot: 5361/2025 të datës 05.08.2025 të KPMSHCK-së. Ka pasur vlerësim jo objektiv të intervistës.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe këtë e bënë përmes dy funksioneve të përcaktuara sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet: *1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil; 1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, andaj mbi bazë të funksionit të paraparë sipas nën paragrafi 1.1 të nenit 6 të këtij ligji, dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 86 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: 1. Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 3. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre, e për rrjedhojë mbi bazë të këtij kuadri ligjor, Kolegji i Këshillit, do të shqyrtoj në tërësi procedurën e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017448, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Politika, nga inicimi i procedurës së pranimit deri në përfundimin e saj.*

Si rezultat i kësaj, nga data 25 shtator 2023, është në fuqi Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe si pasojë më hyrjen në fuqi të këtij ligji, marrëdhënia e punës e në veçanti çështjet lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës në shërbim civil duhet të behën në pajtim me dispozitat e nenit 35 të këtij ligji, e më të cilat dispozita është përcaktuar se : *1.Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë ë pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë*

(6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm. Andaj, duke qenë se më hyrjen në fuqi të këtij ligji pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI, ka qenë e lirë dhe e njëjta ka qenë duke u ushtruar me zëvendësues, respektivisht përmes Vendimit me Nr. Port: 4882 të datës 07.06.2021, Vendimit me Nr. Pot: 2963/22 të datës 24.05.2022, Vendimit me Nr. 225 të datës 07.06.2023, Vendimit me Nr. 226 të datës 08.06.2023, ndërsa si ushtrues detyrës është caktuar sipas Vendimit me Nr. 313 të datës 11.10.2024 dhe sipas Vendimit me Nr. 315 të datës 19.12.2024, kështu që si rezultat i këtyre vendimeve, Kolegji i Këshillit, konstaton se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë ka qenë fillimisht si zëvendësues, ndërsa nga data 11.10.2024 e deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publik është mbajtur me ushtrues detyre, e përkitazi me këtë Kolegji, konstaton se sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është parashikuar instituti i zëvendësuesit por vetëm ushtruesit të detyrës, e për rrjedhojë duke qenë që kjo pozitë ka qenë e lirë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, atëherë vijmë në përfundimin se e njëjta është mbajtur më gjatë së një vit me ushtrues detyrë në kundërshtim të plotë me nenin 35 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që në kuadër të kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit prej një viti është i paligjshëm, atëherë në këtë kontekst nxjerrja e Vendimit me numër protokolli 4285/25 të datës 29.05.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit, respektivisht Vendimit me numër protokolli 4285-2/25 të datës 30.05.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 29.05.2025 për formimin e komisionit të pranimit nga ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së janë të paligjshme për arsyet e cekura më lartë, sepse pozita e Sekretarit të Zyrës së MMPHI nga data 25.09.2024 e deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtaret Publik, është mbajtur me ushtrues detyre në kundërshtim me dispozitat ligjore. Lidhur me konstatimet e dhëna si më lartë, Kolegji i Këshillit ju referuar edhe Aktgjykimit P.A.nr.07/2025, të datës 10.06.2025, të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku ndër të tjera është konstatuar se: ...Nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë mujor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike.

Në mbështetje të konstatimit të dhënë si më lartë, gjegjësisht, duke qenë se aprovimi i shpalljes së procedurës së rekrutimit dhe emërimi i Komisionit të Pranimit nuk ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore, atëherë Kolegji i Këshillit, rithekson faktin se institucionet e administratës publike janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht dispozitat e nenit 4, ku përcaktohet se: “1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj”, e në këtë rast ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes së

Republikës së Kosovës, me rastin e marrjes së veprimeve në procedure të pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017448, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Politika ka vepruar pa kompetencë, me çka veprimet e tij bëjnë që aktet e nxjerra nga ana e tij në këtë proces janë të paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme*, andaj përkitazi me këtë, Kolegji i Këshillit, nuk ka shqyrtuar as fazat tjera të procedurës së pranimit për pozitën e cekur më lartë, ngase nxjerrja e Vendimit me numër protokolli 4285/25 të datës 29.05.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit, respektivisht Vendimit me numër protokolli 4287-2/25 të datës 30.05.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 29.05.2025 për formimin e komisionit të pranimit, nga ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Zyrës së MMPHI-së, e kanë bërë të pavlefshme këtë procedurë të pranimit, kështu që për sa më sipër Kolegji sipas këtyre rrethanave, vendosi të aprovojë ankesën e ankueses, të anuloj në tërësi procedurën e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017448, dhe si rrjedhojë çdo veprim tjetër të ndërmarr nga kjo procedurë e rekrutimit, ndërsa në pajtim me dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi Njësia e Burimeve Njerëzore e MMPHI-së që në pajtim me dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi të ndërmarr të gjitha veprimet juridike.

Kështu që, thënë si më sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1636/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.Z;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.